

VENDIM
Nr.574, datë 23.8.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GRABIAN, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Grabian, të qarkut të Fierit, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Grabian, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.133, datë 11.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Grabian”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Grabian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Grabian

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-4	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
5-7	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
8-10	Varrezat publike	Në pronësi
11-13,20,26,39,41,42,	Infrastrukturë dhe shërbim publik	Në përdorim
14-19,21,22-25,27-38,40,43-47	Infrastrukturë (sheshe)	Në pronësi
48,49,50,117-193	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
51-68	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
75-78	Sisteme të ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
83-84	Ndriçimi publik	Në pronësi
85-98	Infrastrukturë rrugore	Në pronësi
99,101	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
100,108,105,111,115	Toka bujqësore inproduktive, kanale të treta	Në pronësi